



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më .10.2024

MBLEDHJA Nr. 44,
Datë 05.11.2024, ora 13:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Martë, datë 05.11.2024, ora 13:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 44 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi kërkesën e shoqërisë “DELTA PLAN STUDIO” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “VOLTON” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “AXPO ALBANIA” sh.a. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
4. Mbi dhënien e garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga parku fotovoltaiik “Nova Solar System”, i shoqërisë “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k.
5. Mbi dhënien e garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar në muajin gusht 2024 nga parku fotovoltaiik “Blue 1”, i shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k
6. Mbi miratimin e një ndryshimi në “Kodin e Rrjetit TAP” dhe “Kodin Tarifor të TAP”.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI